




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Komuna e Gjiçanit
Kryetari i Komunës

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nenit 4, paragrafi 1, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.4.1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr.03/L-139, të Republikës së Kosovës dhe Vendimit të Kuvendit Komunal të Gjiçanit, 01.nr.8030/020 të datës 04.10.2002 Për Aproximin e Planit Detaj Urbanistik: "Zona Perëndimore" e Qytetit të Gjiçanit (i njohur si QARKU-2002), Organi Shpronësues, merr këtë:

VENDIM PRELIMINAR

Kryetari i Komunës, APROVON – me vetiniciativë shpronësimin e ngastrës kadastrale për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik - sigurimin e tokës për nevoja të hapjes së rrugës të paraparë me Planit Detaj Urbanistik: "Zona Perëndimore - Qarku 2002" e Qytetit të Gjiçanit i miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit me Vendimin 01.nr.8030/020 të datës 04.10.2002:

-Ngastrën kadastrale nr.823-13, ZK Gjiçan, në vendin e quajtur "Jaruge", pronar Sabri (Imer) Bunjaku, në sipërfaqe prej 300m², me kulturë - arë e klasës 3.

II. VËRTETOHET se është qëllim i ligjshëm publik dhe i domosdoshëm - sigurimi i tokës për ndërtimin e rrugëve të paraparë sipas Planit Detaj Urbanistik: "Zona Perëndimore-Qarku 2002" e Qytetit të Gjiçanit dhe shpronësimi është në funksion të arritjes së këtij qëllimi të ligjshëm publik.

III. Vendimin Preliminar brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, organi shpronësues do t'ia dërgon pronarëve, zotëruesit të interesit të pronës dhe personave tjerë që pretendojnë se i takon një e drejtë në pronën e shpronësuar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi brenda 10 ditëve pas miratimit dhe në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madhë në Kosovë.